


HORIZON 2020



FAST TRACK TO INNOVATION (AKSIONI PILOT FTI)

AKTI

SEKTORI I TEKNOLOGJISE DHE INOVACIONIT

QERSHOR 2015

WWW.AKTI.GOV.AL

AKSIONI PILOT FTI

(FAST TRACK TO INNOVATION)

Fti është një aksion pilot në kuadër të Programit Horizon 2020, që ofron mbështetje financiare per vitet 2015-2016 për përshpejtimin e finalizimit të projekteve të inovacionit.



FTI funksionon sipas qasjes *poshtë-lart* duke mos përcaktuar tema specifike, dhe është i hapur për të gjithë kategoritë e aktorëve të përfshirë në fushën e inovacionit.

Aplikuesit mund të përcaktojnë vetë temën por duke iu referuar objektivave të programeve specifike "Societal Challenges" dhe "Leadership in Enabling and Industrial Technologies".

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/leadership-enabling-and-industrial-technologies>.

Liria tematike së bashku me mundësinë e pjesëmarrjes së të gjithë kategorive të aktorëve të fushës së inovacionit synojnë të realizojnë një nga qëllimet e kësaj nisme - bashkëpunimin ndërsektorial dhe ndërdisiplinor.

Fokus i kësaj nisme është kategoria e "Industrive" me të cilën kuptohen Organizata Private Fitimprurëse -

Ndërmarrje të Mëdha, Klastera, Shoqata Industriale, Shoqata Biznesi, Përdorues Final, Investitorë, - si dhe sektori publik, SME-të.

1. Çfarë synon FTI ?

FTI synon:

- të reduktojë hapësirën kohore ndërmjet zhvillimit të konceptit dhe komercializimit.
- të rrisë pjesëmarrjen e Industrive, SME-ve, dhe veçanërisht aplikuesve që aplikojnë për here të parë nga kategoria "Industritë"

- të rrisë investimet e sektorit privat në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

2. Kush mund të aplikojë?

Vetëm konsorciume të përbëra nga tre deri pesë subjekte juridike, nga vende antare të BE-së ose vende të asociuara të



Horizon 2020. Partnerët në konsorciume duhet të jenë nga të paktën tre vende të ndryshme. Gjithashtu, ka

edhe kushte të veçanta lidhur me pjesëmarrjen e kategorisë "Industritë". Në kategorinë "Industritë" përfshihen Biznese Private Fitimpruese.

3. Cilat janë kushtet lidhur me pjesëmarrjen tek "Industrite":

* të paktën 60% e buxhetit të përgjithshëm duhet të shkojë për partnerët e konsorciumit nga kategoria "Industritë"

* ose: në një konsorcium të përbërë nga 3 ose 4 partnerë, të paktën 2 duhet të jenë nga kategoria "Industritë"

* ose: në një konsorcium të përbërë nga 5 partnerë, të

paktën 3 duhet të jenë nga kategoria "Industritë"

4. A është kusht për aplikim partneriteti me studiues, universitete apo institucione kërkimore jashtë Shqipërisë?

Nuk është kusht, fokus i kësaj iniciative janë aktivitetet nga faza TRL6 deri tek komercializimi.



5. A nevojitet bashkëfinancim nga aplikanti qoftë ky individ apo institucion ?

Bashkëfinancimi nga aplikantët shkon në masën 30%.

6. Sa është min dhe max i shumës së grantit që ofrohet për aplikantin ?

Min. është 1 Mil. € dhe max. i kontributit për projekt mund të shkojë deri në 3 mil. € (70% e financimit, 100% per org. jo fitimpruese)



7. Sa është kohëzgjatja mesatare e nje projekti ?

Zbatimi i projektit shkon nga 1 deri ne 2 vjet.

Komercializimi duhet të arrihet brenda 3 viteve nga fillimi i zbatimit te projektit.

8. Ku mund të gjenden thirrjet për aplikim ?

Thirrja e cila është vazhdimisht e hapur deri në fund të vitit 2016 mund të gjendet në linkun qe pason:

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/desktop/en/opportunities/h2020/calls/h2020-ftipilot-2015-1.html#tab2>

9. Cilat janë hapat për një aplikant që aplikon për herë të parë ?

Hapi i parë është kontakti me Pikën Kombëtare të Kontaktit i cili mund tju udhëzojë nëse FTI është instrumenti i përshtatshëm

për organizatën apo konsorciumin tuaj.

Hapi tjetër është konsultimi me faqen zyrtare të thirrjes së FTI, si dhe me seksionin

dedikuar FTI-së në Planin e Punës të Programit Horizon2020. (Horizon 2020 Work Programme)

